



## STATUTI

### I SHOQERISË SË BASHKËPUNIMIT BUJQËSOR “PULTI PËR ZHVILLIM – SHKODËR ALBANIA”

#### NENI 1

##### Emertimi i Shoqerisë dhe baza Ligjore e veprimtarisë:

##### 1. Emertimi i shoqërisë është:

Shoqëria e Bashkëpunimit Bujqësorë “PULTI PËR ZHVILLIM – SHKODËR ALBANIA”

2. Shoqëria e Bashkëpunimit Bujqësorë “PULTI PËR ZHVILLIM – SHKODËR ALBANIA” themelohet, organizohet dhe funksionon në bazë të ligjit Nr. 38/2012, datë 05.04.2012 “Përshoqëritë e bashkëpunimit bujqësor” gjithë akteve të tjera ligjore e nënligjore në fuqi, si dhe në bazë të rregullave të përcaktuara në këtë statut.

#### Neni 2

##### Stemadhevula e Shoqerisë

Shoqëria ka stemen e saj, në formë rrethore ku sipershkruhet **PULTI PËR ZHVILLIM**, ndersa poshtë **SHKODËR ALBANIA**.

Shoqëria ka vulen e saj rrethore në të cilën shkruhet si mëposhtë:

**SH.B.B. “PULTI PËR ZHVILLIM – SHKODËR ALBANIA”**.

#### Neni 3

##### Adresa e selise:

Kjo Shoqëri e ka selinë e saj në adresen:

Rruga Vas Kiri 03450013, Nd. 33, H1, Fshati Kir, Njësia Administrative Pult, Bashkia  
Shkodër

**Neni 4**  
**Shtrirja e Aktivitetit**

Shoqëria e shtrinë aktivitetin e saj në të gjithë territorin e Shqipërisë dhe jashtë saj me qëllim zhvillimin e komunitetit të Pultit dhe në dobi të tij.


**Neni 5**  
**Kohëzgjatja e veprimtarisë.**

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj pa afat.

**Neni 6**  
**Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë.**

**Objekti i veprimtarisë së kësaj Shoqërie është:**

- a) Përmirësimi i jetesës në Njësinë Administrative Pult dhe më gjerë, me anë të bujqësisë, blegtorisë, pemtarisë, bletarisë, turizmit, mjedisit, pyjeve, infrastruktures, gastronomisë, bimëve medicinale, përpunimit të frutave të pyllit, prodhimeve bio, sportit etje.
- b) Të blejë, përpunojë, të prodhojë, të fabrikojë, çdo lloj veprimtarie bujqësore, blegtorale, pemë frutore ,fruta pylli, bimë mjeksore, fidanë dhe fara të gjitha llojeve, materiale, mjete bujqësore, makineri të ndryshme dhe paisje që i shërbejnë përpunimit të produkteve dhe bimëve mjeksore, përpunimit të mjaltit dhe paisjeve të mirëmbajtjes së infrastrukturës brenda trritorit të Njësisë Pult dhe jashtë saj. Çdo gjë tjetër që i shërben turizmit malor, ruajtjes së mjedisit, turizmit ujor, ruajtjes së farerave autoktone dhe ruajtjen e trashigimisë kulturore të zones së Pultit.
- c) Zhvillimi i turizmit. Shoqëria "PULTI PËR ZHVILLIM – SHKODËR ALBANIA" do të punojë për zhvillimin e turizmit të qëndrueshem, si burim i të mirave në interes të komunitetit.




- 
1. Prioritet kryesor do të jetë zhvillimi i agro – turizmit dhe turizmit malor dhe lumor.
  2. Ngritjen e një zyre për promovimin e turizmit të zones së Pultit dhe Dukagjinit.
  3. Bashkë me partnerë do të zbatojmë inisiativa të reja në turizem duke ngritur standarte cilësore, duke ofruar traditen tonë , mikëpritjen, gastronominë tradicionale, produktet Bio, duke konkuruar me dinjitet në tregun turistik.
  4. Do të nxitë krijimin e sporteve ujore dhe sporteve të tjera, si alpinizem, hipizem, kanotazhe, ski, hiking, shetitje me bicikleta, motora etje.
  5. Zhvillimi Ambiental, të punojmë për natyren dhe jo kunder saj, të punojmë kunder keqperdorimit të burimeve natyrore, shkatërrimit të pyjeve. Shoqëria ka si prioritet ruajtjen e mjedisit dhe do punojë me sjelljen e pikëpamjeve njerzore ndaj ambientit duke filluar nga mashot e reja e vazhduar me institucionet e vendimarrëse sipas konventes së Kiotos dhe konformë me direktivat e komunitetit European.

#### d) Ruajtja e Diversitetit

1. "SIIBB Pult për Zhvillim Shkodër Albania" do të punojë energjikisht në ruajtje e diversitetit Flores dhe Faunes së pasurise se zonës. Në këtë territory ka një shumëllojshmëri të specie dhe kafshëve e shpëndëve të cilët përbëjnë një pasuri të madhe.
2. SHBB Pult do të punojë fuqishem për ruajtjen dhe shtimin e bimëve mjeksore, për shpëndet e rrallë si thellenza, për kafshët si kaprolli, derri i eger, frutat e pyllit si thana, boronica, farat e venditsifasulja, patatjaetje.

#### Objektivate veprimtarisë së Shoqërisë do të jenë:

1. Të ruaj, të klasifikojë, të transformojë, të transportojë, të shpërndajë dhe të trëgtojë, madje edhe drejtpërdrejtë më konsumatorin produktet që vine nga fermerat e





Shqipërisë dhe nga ato të anëtarëve në gjëndjen e tyre natyrore ose të ndryshuara më parë.

2. Të blejë, të ndajë në ngastra të përmirsojë terrenet që janë të caktuara për aktivitetet bujqësore, për mbarshtrimin e bagëtive ose pyjet, por dhe të ndërtojë dhe krijojë mjetet dhe paisjet e nevojshme për arritjen e këtyre qëllimeve.
3. Të programojë prodhimin dhe ta përshtasë atë me kërkesën, në veçanti përsa i takon sasisë dhe cilësisë, të nxisë përqëndrimin e ofertës dhe nxjerrjen në treg të produkteve të anëtarëve të shoqërisë, të zvogëlojë kostot e prodhimit dhe të rregullojë çmimet e tregut, por edhe të nxisë metoda kultivimi, prodhimi, dhe administrimi të mbetjeve për mbrojtjen e mjedisit në veçanti, për mbrojtjen e cilësisë së ujrave, të tokës, të peisazhit si dhe ruajtjen e biodiversitetit.
4. Të nxisë çfarëdo lloj aktivitetesh të tjera që janë të nevojshme ose shërbejnë nëpër përmirsimin ekonomik, financiar, teknik të shoqërisë, të anëtarëve të sajë ose fermave të tyre respective, që lehtësojnë në punën dhe mbarshtrimin e bagëtive, që ruajnë mjedisin dhe të nxisë në veçanti trajtimet dhe shkëmbimet midis shoqërive të ndryshme.
5. Të kryejë çdo lloj aktiviteti tjetër lidhur në mënyrë direkte ose indirekte me pikat 1,2,3,4.

#### Neni 7

#### Qëllimi i veprimtarisë së shoqërisë.

Qëllimi i veprimtarisë së kësaj shoqërie është:

Të përmirësojë gjëndjen shoqërore – ekonomike të anëtarëve dhe komunitetit të njësisë Administrative Pult për mes një menaxhimi të përbashkët të aktiviteteve të tyre ekonomike.

## Neni 8

### Aktivitetet me persona të tretë.

- a. Shoqëria mund të zhvillojë operacione me persona të tretë që nuk janë anëtarë maksimumi deri në 40% të totalit të ardhurave nga veprimtaritë e saj, gjithmonë në përputhje me dispozitat e këtij statuti.
- b. Aktivitetet me personat e tretë duhet të regjistrohen në mënyrë të ndarë dhe të saktë me qëllim që të llogariten.

## Neni 8/1

### Rikompozimi i Qendrës Burimore për Përmakulturën në Shoqëria e Bashkëpunimit Bujqësorë "Pulti për Zhvillim"

- a. Rikompozimi i Qendrës Burimore për Përmakulturën në Shoqëria e Bashkëpunimit Bujqësorë "Pulti për Zhvillim Shkodër- Albania"
- b. Ku të gjithë burimet material të Qendrës Burimore për Përmakulturën i kalojnë Shoqërisë së Bashkëpunimit Bujqësorë "Pulti për Zhvillim Shkodër - Albania"

## KAPITULLI I DYTË

### ANËTARËT E SHOQËRISË SË BASHKËPUNIMIT BUJQËSOR


## Neni 9

### Antaresia e shoqërisë

Anëtarë të shoqërisë janë personat fizik e ose juridike, të cilët përmbushin nevojat dhe interesat e tyre, lidhur me veprimtarinë bujqësore dhe blegtorale që ushtrojnë, nepermjet shërbimeve, mallrave apo produkteve të ofruara nga shoqëria.

Kushtet për pranimin e anetarit në kete shoqeri janë:

1. Të ketë prodhim bujqësor dhe/ose blegtoral për treg.



2. Te ketë një fermë bujqësore në rrethin e Shkodres.
3. Pranon statutin.
4. Pagan kuotën e kapitalit themeltar të shoqërisë.

## Neni 10

### Proçesi i pranimit

1. I interesuari duhet të paraqesë një kërkesë pranimi, me shkrim dhe i drejtohet administratorit, i cili ia kalon kërkesen asamblesë së përgjithshme në mbledhjen e saj më të parë. Asambleja duhet të vendosë brenda një afati jo më shumë se 12 muaj. Vendimi i Asamblesë do të jetë në cilindo rast i shpjeguar dhe do ti bëhet i ditur të interesuarit me çfarëdo lloj mjeti që verteton marrjen e tij, pa prekur shpalljen e tij ne tabelen e njoftimeve në Selinë e Shoqërisë. Nese ka kaluar afati i mësipërm dhe Asambleja nuk ka marrë një vendim, do të konsiderohet e miratuar kerkesa për pranim.

2. Në rastet kur kerkesa për pranim nuk është pranuar, kërkuesi mund të apelojë tek Asambleja e Përgjithshme brenda 20 ditëve që nga data kur u bë i ditur vendimi. Apelimi duhet te shqyrtohet nga Asambleja e Përgjithshme që në mbledhjen e saj të parë, me votim të fshehtë dhe ku është e detyrueshme pjesmarrja e pales së interesuar.

3. Vendimi i pranimit i marrë nga Asambleja mund të kundërshtohet pranë saj brenda 10 diteve që nga dita kur ai u bë i ditur dhe me kërkesë të 15 % të të gjithë anetareve. Apelimi duhet të shqyrtohet nga Asambleja e Përgjithshme që në mbledhjen e saj të parë, ku është e detyrueshme pjesmarrja e pales së interesuar.

4. Marrja e statusit të anëtarit nuk do të bëhet e ditur derisa të ketë kaluar afati për të apeluar pranimin ose nëse është e pranuar derisa të vendosë Asambleja e Përgjithshme.

5. Pranimi i anëtarit të ri shoqërohet menëshkrimin e kontributit dhe derdhjen e kontributit të detyrueshem në kapitalin shoqëror, në përputhje me parashikime te statudit.

## Neni 11

### Rregjistrimi

1. Shoqeria mban në selinë e saj një regjister të anetareve i cili është public dhe i konsultueshem dhe që përmban të gjitha të dhënat e tyre identifikuese, adresat si dhe kapitalin e nënshkruar e të shlyer prej tyre. Në regjister do të shënohen edhe data e pranimit apo të largimit të anëtarëve të shoqërisë. Anëtarët do të njoftohen për regjistrim në Qendrën Kombëtarë të Regjistrimit.

## Neni 12

### Humbja e drejtës së antaresisë

1. Anetari e humb të drejtën e antaresisë kur plotësohen kushtet e përcaktuara në ligj apo në statut për humbjen e kesaj te drejte si dhe kur ai përjashtohet nga shoqeria.

2. Anëtari humb të drejtën e antaresisë:

a) vullnetarisht, me anë të dorëheqjes;

b) kur, transferon pjesën e zotëruar prej tij në kapitalin e shoqërisë të një individi ose person juridik, i cili ka marrë miratimin e asamblesë së përgjithshme për të qënë anëtarë;

c) në rast likuidimi, kur anetari është person juridik;

d) në rast falimentimi;

e) në rast vdekjeje;

f) në çdo rast tjetër të përcaktuar në vazhdimësi në ligj apo në statut.

3. Administratori shprehet me vendim të motivuar për largimin e anëtarit kur konstaton secilin prej raste vetë parashikuara në pikën 1 të këtij neni, dhe vendimi në marrë ia përcjellë për miratim Asamblesës Përgjithshme.

4. Në rastin e dhenies së dorëheqjes, si dhe të qëllimit të anëtarit për transferimin e pjesës së zotëruar anetari duhet të dërgojë një njoftim paraprak me shkrim drejtuar Administratorit. Administratori brenda 30 ditësh nga marrja e njoftimit përgatit mendimin e tij mbi pasojat e largimit të anëtarit mbi kapitalin e shoqërisë dhe ja kalon për miratim Asamblesës. Nëse Administratori nuk shprehet brenda afatit prej 30 ditësh mbi pasojat e largimit, atëherë

*[Handwritten signatures and initials]*  
10/22  
11/22  
12/22

largimi do të konsiderohet i pademshem dhe Administratori i kalon Asamblesë kërkesën për doreheqje e cila e miraton atë si të pademshme për shoqërinë.

5. Në rastine njoftimit për transferim të pjesës së zotëruara të here Administratori brenda 30 ditësh nga marrja e njoftimit përgatit mendimin e tij mbi pasojat e largimit të anëtarit mbi kapitalin shoqërisë dhe ja kalon për miratim Asamblesë. Nëse Administratori nuk shprehet brenda afatit prej 30 ditësh mbi pasojat e largimit, atëherë largimi do të konsiderohet i pademshem dhe Administratori i kalon Asamblesë kërkesën për doreheqje e cila e miraton atë si të pademshme për shoqërinë. Së bashku me njoftimin për transferim të pjesës nga ana e anëtarit, i interesuari i cili do të marrë pjesën e anëtarit në largim duhet të plotësojë procedurat për anëtarësim sipas nenit 10 të Statutit.


6. Nërastet e perjashtimit sipas përcaktimeve të parashikuara në ligj, Asambleja e Pëgjithshme me propozim të argumentuar të Administratorit dhe përmes një vendimi të argumentuar përjashton anëtarin nga shoqëria përrarsyet e mëposhtme:

- a) ka kryer shkeljet e rëndë të detyrave të tij të përcaktuara në ligj dhe në statut ose ka vepruar në kundërshtim me interesat e shoqërisë;
- b) nuk plotëson kriteret për të qenë anëtar, sipas dispozitave të ligjit dhe këtij statuti.
- c) ka shkelur detyrimet e tij të përcaktuara në shkronjat "b", "d", "e" dhe "ë" të nenit 15 të ligjit nr. 38./2012 "Për shoqëritë e bashkëpunimit hujqësor";
- ç) përfshihet në veprime të cilat e bejnë të pamundur vazhdimin e mardhënieve ndërmjet anëtarit dhe shoqërisë.
- d) për arsye të tjera të përcaktuara në këtë statut;

7. Vendimi i largimit nga shoqëria i njoftohet anëtarit menjëherë.

8. Anëtarit ka të drejtë të ngrejë padi në gjykatë për vendimin e shoqërisë për përjashtimin e tij.

9. Largimi i anëtarit duhet të shënohet në regjistrin e anëtarëve, që mbahet nga shoqëria, si dhe të regjistrohet në Qendren Kombëtare të Regjistrimit.



### Neni 13

#### Të drejtat e anëtarëve

Perveçsa parashikohet në ligj, anëtarët kanë te drejtat si mëposhtë:

- a) Pjesëmarrja në Asamblene e Pergjithshme të Shoqerisë me të drejtë vote;
- b) Prezantimi i kandidatures së tij për zgjedhjet si Administrator;
- c) Njoftja e çdo dokumentiqë ka Shoqeria e që ka të bëjë direkt me të;
- d) Të marrë pjesë në aktivitetet sipërmarrëse të kooperatives për të përmbushur detyrimet sociale pa dallime;
- e) Të marrë informacionin e duhur në mënyrë që anëtarit ë përfitojë të drejtat e tij dhe të përmbushë detyrimet.

### Neni 14

#### Transparenca dhe e Drejta e Informimit


1. Çdo anetarë mund të ushtrojë të drejtën e informimit sipas termave të parashikuara me ligj, sipas termave të këtij statute ose sipas vendimeve të Asamblese së Pergjithshme. Në menyrë të veçantë anetari ka të drejtë të:

2. Të marrë një kopje të statutit të shoqërisë dhe një kopje të Rregullores së Regjimit të Brendshem, të ndryshimeve të tyre dhe ku përmendet momenti kur këto të fundit kanë hyrë në fuqi.

3. Të ketë akses të lirë tek Libri i regjistrit të anëtarëve të shoqërisë, por edhe tek libri i procesverbaleve të Asamblesë së Pergjithshme, dhe nese e kerkon, Administratori duhet ti jap një kopje të çertifikuar të vendimeve të marra në Asamblenë e Pergjithshme.

4. Të marrë nga Administratori, nese e kërkon, një kopje të çertifikuar të vendimeve të Asamblesë që prekin në menyrë të veçantë anëtarin. Anetari ka gjithashtu të drejtë që ti tregohet dhe sqarohet , jo më shumë se për një muaj, gjëndja e ekonomike në lidhje me Shoqërinë.

5. Të kontrollojë në sili, dhenë afatin midis njoftimit përmbajtjen e Asamblesë dhe mbajtjes së saj, dokumentet që i dorëzohen asaj dhe në mënyrë të veçantë llogaritë vjetore, raportin e menaxhimit, kërkesën për shpërndarjen e rezultateve.



Handwritten signatures and dates at the bottom of the page, including a date '02/21'.

## Neni 15

### Detyrimet e anëtarëve

Detyrimet e anëtarëve të shoqërisë, shkeljet e të cilave janë të ndeshkueshme janë:


- a. Të respektojë statutin dhe rregulloren
- b. Tu përmbahen vendimeve të Asamblesës Përgjithshme dhe Administratorit.
- c. Të jetë i pranishëm në mbledhjet e Asamblesës Përgjithshme dhe mbledhjet e organeve të tjera tek të cilat bëjnë pjesë.
- d. Të ruajn fshehtësinë për ato çeshtje ose të dhëna të shoqërisë përhapjen e të cilave mund të dëmtojë interes e ligjshme të shoqërisë.
- e. Të përdorë me kujdes dhe të mirëmbajë makineritë dhe materialet që janë pronë e shoqërisë.
- f. Të mos zhvillojë një aktivitet ekonomik që krijon konkurrencë me aktivitetin e shoqërisë vetëm në rast autorizimi nga Administratori.
- g. Të pranojnë ato detyra për të cilat u zgjodhën, me përjashtim të rasteve kur ka një justifikim të vlefshëm.
- h. Të japë kontributet në kapitalin themeltar sipas menyres dhe afateve të përcaktuara.
- i. Të përmbushë detyrimet e tjera ekonomike që i takojnë.
- j. Të marrë pjesë në aktivitetet e trajnimit.
- k. Të përmbushë detyrat e tjera që rrjedhin nga urdheresa ligjore dhe nga ky statut.

## Neni 16

### Norma të disiplinës sociale

Anëtarët mund të denohen vetëm për shkeljet e përcaktuara shprehimisht tek ky statut.

1. Anëtarëve mund tu vihen vetëm ato sanksione që për çdo lloj shkeljeje janë të përcaktuara në statut.
2. Konsiderohen si shkelje shumë të rënda:



Handwritten signatures and initials at the bottom of the page, including names like 'Migjeni', 'Jhej', 'Duran', 'Ego', 'Migjeni', and '0/20'.


- a) Veprimet e konkurrencës së pandershme, mashtrime me kontributet në kapitalin themeltarë. Këto veprime dëmtojnë interes material dhe prestigjin e shoqërisë.
- b) Fallsifikimi i dokumentave, firmave, pullave të postë, vulave, markave, logotipeve, çelsave apo të dhënave të ngjashme, që shërbejnë për lidhjen e shoqërisë me anëtarët e saj ose me persona të tretë.
- c) Nxjerrja e sekreteve të shoqërisë që demtojnë rëndë interes të saj.
- d) Mospërmbushja e detyrimeve ekonomike me Shoqërinë.
- e) Përfitimi nga fakti i të qenit anëtarë i shoqërisë për të zhvilluar aktivitete speculative ose që janë në kundërshtim me ligjet.
- f) Mashtrimi ose fshehja e të dhënave të rëndësishme që kanë të bëjnë me kulturat dhe prodhimet e marrura, me dhënjen apo dorëzimin e frutave apo me produktet ose lëndet e para.
- g) Abuzimet financiare me fondet e shoqërisë.

3. Konsiderohen si shkelje të rënda:

- a) Mospjesmarrja e pajustificueshme në mbledhjet e Asamblesë të Përgjithshme të lajmëruara në kohën e duhur edhe pasi anëtari është saksionuar dy herë përshkelje të lehta që lidhen me mospjesmarrjen në mbledhjet e këtij organi në pesëvitet e fundit.
- b) Agresione me fjalë ose me vepra ndaj anëtarëve të tjerë gjatë mbledhjeve të organëve kryesore ose gjatë realizimit të punëve, aktiviteteve ose operacioneve për arritjen e objektivave kryesore të shoqërisë.
- c) Kryerja e një shkelje të lehtë kur anëtari është dënuar më parë për tre shkelje të lehta që nuk përfshihen te paragrafi a) 1 mëparëshem gjatë tre viteve të fundit.

4. Konsiderohen shkelje të lehta:

- a) Mospjesmarrja e pajustificuar në mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme dhe kur anëtari ishte lajmëruar në kohën e duhur.

A series of handwritten signatures and initials in blue ink, located at the bottom of the page. The signatures are somewhat stylized and difficult to read, but they appear to be official or personal marks of the individuals involved in the document.

- b) Shkeljet që përcaktohen në Rregulloren e Regjimit të Brendshëm të miratuar nga Asambleja e Përgjithshme ose me vendim të Asamblesë së përgjithshme.
- c) Shkeljet që bëhen përherë të parën daj këtij statuti dhe që nuk janë të parashikuara tek paragrafët e rregullores të shkeljeve të rënda ose më pak të rënda.
5. Saknsionet që mund ti vihen anëtarëve për kryerjen e shkeljeve përcaktohen me në detaj në Rregulloren e Regjimit të Brendshme të miratuar nga Asambleja e Pergjithshme.

## KAPITULLI I TRETË

### ORGANET E SHOQËRISË

#### Pjesa e Parë :Asambleja e Përgjithshme.

#### Neni 17

#### Organet e Shoqërisë.


Organet e shoqerisejanëkëtotëmëposhtmet:

- 1) Asambleja e Pergjithshme
- 2) Administratori.

#### Neni 18

#### Asambleja e Përgjithshme

- a) Asambleja e Përgjithshme, e themeluar në përputhje me këtë statut, është mbledhja e anëtarëve për të shqyrtuar dhe për të marrë vendime, si organ me suprem I shprehjes së vullnetit të shoqërisë mbi ato çështje që asaj I takojnë sipas ligjit ose statutit.
- b) Vendimet e Asamblesësë Përgjithshme të marrura në përputhje me ligjet dhe me këtë Statut, janë të detyrueshme për të gjithë anëtarët për fshirë këtu ato që janë kundra dhe ato që nuk kanë marrë pjesë në mbledhje.





- c) Mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme mund të jenë të zakonshme ose të jashtëzakonshme. Asambleja e Përgjithshme, e Zakonshme ka për qëllim kryesor të shqyrtojë administrimin e shoqërisë dhe të miratojë llogaritë vjetore, por gjithashtu mund të përfshijë në rendin e saj të ditës çdo çështje tjetër që I takon Asamblesë. Mbledhjet e tjera të Asamblesë së Përgjithshme konsiderohen si të jashtëzakonshme.
- d) Kur kuorumi kërkon mbledhjen e Asamblesë së përgjithshme gjë që nuk arrihet, Asambleja e Përgjithshme ben rithirrjen me të njëjtin rend të ditës, brenda 30 ditevenga data e deshtimit të mbledhjes së mëparshme.
- e) Çdo anëtarë I Shoqërisë mund të jetë I prezantuar në Asamblenë e Përgjithshme nga një anëtarë tjetër, I cili është I autorizuar përmes një procure speciale, për të ushtuar të drejten e votes në favor të personit që përfaqson në Asamblenë e Përgjithshme.

#### Neni 19

#### Kompetencat e Asamblesë së Përgjithshme


1. Asambleja e Përgjithshme është organ vendimarrës dhe për bëhet nga të gjithë anëtarët e Shoqërisë.
2. Asambleja zgjedh kryetarin dhe sekretarin.
3. Asambleja e Përgjithshme ka këto kompetenca:
  - a) Vendos drejtimin e politikave ekonomike të shoqërisë;
  - b) Analizon raportin e gjendjes financiare, përfshirë llogaritë vjetore, shperndarjen e fitimeve.
  - c) Miraton ngarkimin e humbjeve, menaxhimin financiar dhe çështje të tjera të v eprimtrarisë ekonomike, që çmohen të rëndësishme;
  - d) Emeron dhe shkarkon Administraorin, ekspertin kontabel dhe likujducsin, dhe përcakton masën e shperblimit të tyre;
  - e) Miraton zvogelimin apo zmadhimin e kapitalit;
  - f) Miraton ndryshimet e statullit;

 06/22









 09/22

- g) Vendosë tës hpërndajë apo mënyrën e përdorimit të fitimit të shoqërisë, sipas dispozitave të këtij ligji dhe statuti.
- h) Vendosëshkrirjen, ndarjen, transformimin apo shpërnadrjen e shoqërisë;
- i) Vendosë për ndryshimet e struktures ekonomike, shoqërore, organizative apo funksionale të shoqërisë;
- j) Vendosë për pjesëmarrjennë forma të tjera të bashkëpunimit ekonomik dhe me anë të pjesëmarrjes në kapital, aderimin në organizata me karakter përfaqësues dhe shkeputjen prej tyre;
- k) Miraton pasqyrat financiare, raportet për mbarevajtjen e veprimtarisë së shoqërisë, raportet eksperteve kontabel dhe të likuiduesve;
- l) Miraton pranimin e anëtareve të rinj dhe pjesëmarrjen e tyre në kapitalin e shoqërisë, si dhe largimin apo përjashtimin e tyre;
- m) Kryen detyra dhe çështje të tjera të përcaktuara në ligj apo në statut.
- n) Për çështjet që shqyrton, Asambleja e Përgjithshme merr vendimet perkatese, të cilat janë të detyrueshme për të gjithë anëtarët e shoqërisë.

## Neni 20




### Mbledhja e Asamblesë

Asambleja e Përgjithshme thirret të pakten një here në vit dhe brenda gjashtë muajve nga data e mbylljen së vitit financiar. Asambleja e Përgjithshme thirret nga Administratori.

## Neni 21

### Organizimi i mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme.

1. Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme të Zakonshme kryhet nepermjet thirrjes së anëtarëve nga ana e Administratorit, ose nga përfaqësues të anëtarëve që i therrasin nepermjet nje lajmërimi në tabelen e lajmërimeve të selisë së Shoqërisë dhe me anë të çdo qëndre ku zhvillohet aktiviteti i saj.



- 
2. Shpallja ose lajmërimi i mbledhje bëhet të pakten 30 ditë përpara datës së parashikuar përmbajtjen e Asamblesë së Përgjithshme.
  3. Lajmërimi për pjesëmarrësit për mban në mënyrë të detajuar, orën, vendin rendin e ditës dhe llojin e Asamblesë së thirrur.
  4. Rendi i ditës do të përcaktohet nga Administratori, i cili duhet të përfshijë çështjet që, me shkrim, i janë propozuar nga një numër anëtarësh që përfaqsojnë jo më pak se 20 të kapitalit të shoqërisë.

## Neni 22

### E drejta e votës

Çdo anëtarë ka të drejten e një vote në Asamblenë e Përgjithshme.

## Neni 23

### Kuorumi dhe marrja e vendimeve

1. Në rastin e çështjeve për t'u trajtuar në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme, sipas pikës 3 të nenit 19 të këtij statuti, Asambleja mund të marrë vendime të vlefshme, vetëm nëse janë të pranishëm anëtarët me të drejtë vote, të cilët përfaqsojnë më shumë se 30% të kapitalit të Shoqërisë.
2. Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë situatë, Asambleja e Përgjithshme miraton vendimet e saj për çështjet e përcaktuara në pikën 3 të nenit 19 të këtij, me votat e anëtarëve, të cilët përfaqsojnë shumicën e kapitalit të shoqërisë të pranishëm ose të përfaqësuar në mbledhje.
3. Asambleja e Përgjithshme miraton vendimet e saj, në përputhje me përcaktimet e shkronjave "c", "d", "e" dhe "f" të pikës 3 të nenit 20 të këtij ligji, me votat e anëtarëve, të cilët përfaqësojnë tre të katërtat e kapitalit të shoqërisë, të pranishëm ose të përfaqësuar në mbledhje. Kur asambleja duhet të vendosë për çështjet, të cilat përcaktohen në shkronjat "c", "d", "e" dhe "f" të pikës 3 të nenit 20 të këtij ligji, ajo mund të marrë vendime të vlefshme, vetëm nëse janë të pranishëm anëtarët me të drejtë vote, të cilët përfaqësojnë më shumë se 50 përqind të kapitalit të shoqërisë.



2022

Shkurt

Shkurt

Shkurt

Shkurt


Shkurt

- 
4. Nëse Asambleja e Përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur në pikat 1 dhe 2 të këtij neni, asambleja mbledhet përsepi jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.
  5. Votimi është i hapur.
  6. Anëtari duhet të abstenojë kur vendimi që i propozohet Asamblesë ka për qëllim të zgjidh apelimet e bëra nga anëtari ndaj sanksioneve që iu vunë nga Administratori, ashtu si edhe në rastet kur vendimi ka të bëjë me një situatë ku ka konflikt interesi midis anëtarit dhe Shoqërisë.
  7. Përfaqsimi në të drejtën për të votuar duhet të bëhet me anë të një prokure.
  8. Përfaqsimiligjor, me synim për të marrë pjesën e Asamblesë e Përgjithshme i personave ligjor dhe i të mirturve ose të paafitëve, do të bëhet nëpërputhje me normat ligjore që mund të zbatohen.
  9. Vendimet e miratuara nga Asambleja e Përgjithshme hyjnë në fuqi që në momentin që janë miratuar. Kur vendimet janë të parregjistruara, duhet të paraqiten tek Rregjistri i Shoqërisë dokumentet e nevojshme për regjistrimin e tyre Brenda afatit 30 ditëve pas miratimit të procesverbalit, nën përgjegjësinë e Administratorit.

#### Neni 24

#### Procesverbali i Asamblesë

1. Procesverbali i Asamblesë, që duhet hartuar nga vetë sekretari i saj, përshkruan vendin, datën dhe orën e mbledhjes, listën e pjesëmarrësve, nëse mbahet në vendin, datën e mbledhjes, listën e pjesëmarrësve, nëse mbahet në lajmërimin e parë ose të dytë, ekzistencën e kuorumit të mjaftueshëm për tu konsideruar zyrtarë, rendin e ditës, përmbledhjen e diskutimeve dhe marrjeve të fjalës siç janë të shënuara, ashtu si dhe kopja e vendimeve të marrura me rezultatet e votimeve.
2. Procesverbali i mbledhjes mund të miratohet nga vetë Asambleja e Përgjithshme pas aktit të mbjates së saj ose në mungesë të tij duhet të bëhet brenda afatit 15 ditëve, nga kryetari i Asamblesë ose nga 2 anëtarë që nuk kanë asnjë detyrë në atë Asambledhje që do të hedhin firmën e tyre me atë të Sekretarit.








3. Në çdo rast, proçesverbali do të kalojë tek libri i praktikës i Proçesverbaleve nga vetë sekretari i Asamblesë.

## Neni 25

### Administratori

1. Asambleja e përgjithshme zgjedh një anëtarë të Shoqërisë si Administrator të shoqërisë për një periudhë 5 vjet, me të drejtë riperscritjeje.
2. Administratori ka këto kompetenca:
  - a) Kryen të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë së shoqërisë, duke zbatuar politikat e percaktuara nga asambleja e përgjithshme;
  - b) përfaqëson shoqërinë;
  - c) kujdeset përmbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve, të regjistrave dhe të librave kontabel të shoqërisë;
  - c) përgatitë dhe nënshkruan bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, ia paraqet këto dokumente asamblesë së përgjithshme për miratim;
  - d) krijojn një system informimi dhe vlerësimi në kohën e duhur për rrethanat që kërcenojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
  - dh) kryen regjistrimet dhe dergojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë në Qendren Kombetare të Regjistrimit, sipas këtij ligji;
  - e) I raporton Asamblese së Përgjithshme për zbatimin e orientimeve dhe për realizimin e veprimeve të posacme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë;
  - e) kryen detyra të tjera, të percaktuara në ligj dhe në statut.
3. Administratori ka këto detyra:
  - a) I të kryejë detyrat e tij të percaktuara në ligj ose në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vemendje të veçantë realizimit të suksëssem të objektit të shoqërisë dhe ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;



- b) Të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj ose në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të percaktuara në këto dispozita dhe duke konsideruar si të rëndësishëm interesin e shoqërisë dhe të anëtarëve të saj;
- c) Të parandalojë dhe të menjanoj në rastet e konfliktit, prezent apo tëmundshëm, të interesave personale me ata të shoqërisë;
- d) Të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.
4. Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo moment me shumicë të thjeshtë. Administratorit, të cilit ka mbaruar mandati i plotë i emerimit, kryen vete këto detyra, të cilat janë të nevojshme për përmbushjen e detyrimeve ligjore nga ana e Shoqërisë, deri në emerimin e administratorit të ri.

#### Neni 26

#### Zgjedbja e Administratorit



1. Kushtet për të kandiduar për postin e Administratorit janë:
  - a) Të jetë anëtarë i Shoqërisë
  - b) Të mos ketë çështje gjyqësore të paqartësuara me organet publike.
2. Administratori i shoqërisë është Z. Tom Marku.

**KAPITULLI IV**  
**REGJIMI EKONOMIKE**  
**PJESA E PARË**  
**KONTRIBUTET E ANËTARËVE**

#### Neni 27

#### Kapitali themeltar

1. Kapitali themeltar përbëhet nga kontributet e anëtarëve.
2. Kontributet e detyrueshme në kapitalin themeltar do të rregjistrohen në llogarinë mënyrë nominale dhe të ndarë nga hyrjet e tjera të rregjistruara.
3. Nëse shoqëria bën të dituar publikisht shifren e kapitalit themeltar, duhet ta bëjë këtë gjënë një datë të veçantë por duhet edhe të bëjë të ditur se cilët janë



kontribuesit përpërcaktimin e të cilëve do të hiqen, sipas rastit, zbritjet e bëra mbi kontributet për të shlyer humbjet e vëna në ngarkim të anëtarëve.


4. Pjesmarrja për anëtarë në kapitalin themeltar vendoset nga Asambleja.

#### Neni 28

##### Kapitali themeltar minimal dhe anëtarët zotërues të kapitalit

1. Kapitali themeltar dhe i nenshkruari shoqërisë është 100.000 (njëqindmijë lekë).
2. Kapitali I shoqërisë ndahet në 9 (nëntë) pjesë me një vlerë prej 11.110 (njëmbëdhjetëmijë e njëqind e dhjetë) lekë secila.
3. Pjesët e kapitalit të shoqërisë zotërohen nga anëtarët si mëposhtë:

- 1) Tom Marku zotëron 11.2% me një vlerë totale prej 11.120 (njëmbëdhjetë mijë e një qind e njëzet) lekë
- 2) Vilson Peshkaj zotëron 11.1% me një vlerë totale prej 11.110 (njëmbëdhjetë mijë e njëqind e dhjetë) lekë
- 3) Petrit Rrushaj zotëron 11.1% me një vlerë totale prej 11.110 (njëmbëdhjetë mijë e njëqind e dhjetë) lekë
- 4) Majlinda Kalaj zotëron 11.1% me njëvlerë totale prej 11.110 (njëmbëdhjetë mijë e njëqind e dhjetë) lekë
- 5) Vidë Gurra zotëron 11.1% me njëvlerë totale prej 11.110 (njëmbëdhjetëmijë e njëqind e dhjetë) lekë
- 6) Marjan Kurteza zotëron 11.1% me njëvlerë totale prej 11.110 (njëmbëdhjetë mijë e njëqind e dhjetë) lekë
- 7) Nikë Gjinaj zotëron 11.1% me një vlerë totale prej 11.110 (njëmbëdhjetë mijë e njëqind e dhjetë) lekë
- 8) Lekë Sukaj zotëron 11.1% me njëvlerë totale prej 11.110 (njëmbëdhjetëmijë e njëqind e dhjetë) lekë
- 9) Gjin Mani zotëron 11.1% me njëvlerë totale prej 11.110 (njëmbëdhjetëmijë e njëqind e dhjetë) lekë




Totali 100%

4. Nëse nga rezultati i rimbursimit të kontributeve të bëra në kapitalin themeltar ose i zbritjeve të bëra në rastin kur humbjet në ngarkim të anëtarit, kapitali themeltar mbetet më pak se shuma minimale e përcaktuar në këtë nen, shoqëria duhet të shpërbëhet vec në qoftë se një vit nuk ripaguhet ose zvogëlohet shuma e kapitalit të saj minimal nës asitë mjaftueshme.

## Neni 29

### Kontribitet e detyrueshme

1. Kontributi i detyrueshme minimal për të qënë anëtarë do të jetë 1000 (njëmijë) lekë dhe për të fituar statusin e anëtarit duhet të nënshkruhet e gjithë kjo shumë.
2. Asambleja e Përgjithshme mund të vendosë të kërkojë contribute të reja të detyrueshme dhe gjithashtu përcakton sasinë, afatet dhe kushtet e pagesës së tyre. Anëtarit që i ka dhënë kontributet vullnetare mund ti përdorë ato për të mbuluar, tërësisht ose pjesërisht, kontributet e reja të detyrueshme.
3. Anëtarit që nuk është dakort për dhënien e kontributeve të reja të detyrueshme për kapitalin aksioner mund të japë dorëheqje dhe dorëheqja konsiderohet si e justifikuar.
4. Nëse nga vënia në ngarkim i humbjeve të Shoqërisë anëtarëve, kontributi në kapitalin aksioner të ndonjërit prej tyre reduktohet më pak se shuma e përcaktuar si kontributi i detyrueshem minimal për të mbajtur statusin e anëtarit, personi i prekur duhet të paguaj derisa të arrihet ajo shumë. Administratori do të kërkojë që kjo gjë të bëhet menjëherë dhe është ai që do përcaktojë afatin për të bërë pagesën e ky afat nuk mund të jetë më pak se dy muaj e as më shumë se një vit.
5. Anëtarit që nuk bën pagesat brenda afateve të parashikuara duhet ta bëjë këtë gjë ndonëse ka kaluar afati dhe duhet ti paguaj shoqërisë interesin ligjor për





2. Likuidimi I pagesave do të bëhet si pas bilancit të mbylljes të vitit kur ndodh dorëheqja. Nga vlera e vertctuar e pagesave do të zbriten bumbjet që ingarkohen anëtarit dhe për të cilat ai mban përgjegjesi, dhe të pasqyruara në Bilancin e mbylljes së vitit në të cilin bëhet dorëheqja, nese I perkasin ketij viti ose viteve të meparshem dhe nuk janë kompensuar.
3. Administratori do ketë një afat prej tre muajsh që nga data e miratimit të llogarive vjetore të vitit në të cillen është terheq uranëtarit, për të kryer llogarinë e shumës që duhet ti kthehet nga kontributi i tij në kapital. Shuma do ti bëhet e ditur me çfarë dolloj mjete që verteton marrjen e saj.
4. Afati I shlyerjes nuk mund të zgjasë më shumë se pesë vjet që nga data kur u bë dorëheqja.
5. Në rastin e vdeksjes së anëtarit shlyerja ndaj pasuesve duhet të bëhet në një afat jo më shumë se një vit nga vdekja.

**Neni 32**

**Viti ekonomik dhe përcaktimi i rezultatit.**

1. Viti ekonomik ka një kohëzgjatje prej 12 muajsh, ai do të fillojë më 1 janar e do të përfundojë më 31 dhjetor, sipas vitit fiskal në përputhje me afatet e përcaktuara në legjislacionin tatimor dhe atë kontabel në fuqi.
2. Përcaktimi i fitimeve të vitit fiskal realizohet në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 " Për tatimin mbi tëardhurat", të ndryshuar.
3. Do të llogurojnë tek llogaritë në mënyrë të ndarë rezultatet shtesë të shoqërisë ardhura si pasojë e aktiviteteve të shoqërisë me persona të tjerë që nuk janë anëtarë, por dhe rezultatet e arritura nga aktivitetet ekonomike ose nga hurimet që nuk kanë lidhje me qëllimet specifike të shoqërisë.

Handwritten signatures in blue ink, including names like 'Rajko', 'Gjergj', and others, with some initials and dates like '0/22'.

PJESA E DYTË  
FONDET E DETYRUESHME TË SHOQËRISË.

**Neni 33**

**Fondi i reserves së rreziqeve.**

1. Shoqëria krijon fondin e përballimit të riskut, që shërben për përballimin nga shoqëria të rreziqeve apo demëve të çfaredolloj natyre, me të cilat mund të përballlet veprimtaria e shoqërisë, përfshirë këtu edhe fenomenet natyrore apo ato dëme dhe risqe, të cilat janë të lidhura me vetë llojin e veprimtarisë ose të produktit.
2. Shoqëria depoziton në fondin e përballimit të riskut një përqindje të fitimit të saj, e cila përcaktohet në statut, por që nuk mund të jetë më pak se 10 përqind e fitimit neto, të realizuar gjatë vitit financiar paraardhës, pasi të jenë zbritur humbjet e mbartura. Ky fond është i pandashëm ndërmjet anetareve dhe i patransferueshem, përveç rasteve të parashikuara në ligj.

**Neni 34**

**Fondi i rezervës së detyrueshme.**

1. Shoqëria krijon fondin e rezervës së detyrueshme, i cili destinohet për konsolidimin dhe garancinë e kapitalit të shoqërisë së bashkepunimit bujqësor e të aftësisë paguese të saj dhe është i pandashëm ndërmjet anetareve dhe i patransferueshem, përveç rasteve të parashikuara në ligj.
2. Fondi i rezervës së detyrueshme krijohet nga derdhja në këtë fond e jo më pak se 15 përqind të fitimit neto, të realizuar gjatë vitit financiar paraardhës, pasi të jenë zbritur humbjet e mbartura, në masën derisa kjo rezervë të jetë e barabartë me kapitalin e shoqërisë, të parashikuar në ligj.
3. Duhet të shkojnë për këtë fond:



- a. Përqindjet e tepricave të shoqërisë, përqindjet e përfitimeve ekstra të saj dhe përqindjet e posaçme që vendosë Asambleja e Përgjithshme.
- b. Zbritjet nga kontributet e detyrueshme të dhëna për kapitalin themltar në rastet kur dorëheqja e anëtarit është e pajustificueshme.
- c. Me vendim të Asamblesë më tepër se 10 % e shumave që shtohen tepricave dhe përfitimeve të disponueshme shkojnë përkëtë fond.

### PJESA F TRETË

### VITI EKONOMIK.

#### **Neni 35**


#### **Zbatimi i rezultateve pozitive të vitit ekonomik**

1. Nga shtesat e shënuara në llogari për përcaktimin e rezultateve të përbashkëta, pasi janë zbritur humbjet e çdo lloji të viteve të mëparshëm dhe para se të shqyrtohej Tatimi për shoqërinë të pakten 10 % do të shkojë përfondin e rezerves së detyrueshme dhe 50% përfondin e rrizikut.
2. Nga përfitimet ekstra dhe të posaçme të shoqërisë, pasi të jenë zbritur humbjet e çdo lloji të viteve të mëparshëm dhe para se të shqyrtohej Tatimi për Shoqëritë të pakten 10% do të shkojë përfondin e rezerves së detyrueshme dhe kur të jetë mbulaur ai shkojnë përfondin reserve tërreziqeve.

#### **Neni 36**

#### **Shpërndarja e fitimit**

1. Asambleja e Përgjithshme vendos mbi:
  - a. Depozitimim e plotë të fitimit në tone fondet e detyrueshme apo në londe të tjera të krijuara në statut: ose
  - b. Të ndahet midis anëtarëve
2. Në rast të ndarjes së fitimit midis anëtarëve, kjo do të bëhet:



- a. Në proporcion me aktivitetet kryesore të kryera nga sejcili prej tyre me shoqërinë: ose
  - b. Në bazë të përqindjes së kapitalit të zotëruar nga sejcili anëtarë:
  - c. Në bazë të një përllogaritje e cila të marrë parasysh dy mundsitë e mësipërme dhe e cila do të propozohet nga Administratori dhe do të votohet në Asamble:
  - d. Shpërblimi mund të kalojë tek kapitali themeltarë, duke rritur kështu kontributin e dhënë nga sejcili anëtarë në kapitalint hemeltar.
3. Anëtarëve mund tu jepet shpërblimi menjëherë pas miratimit të llogarive të vitit.

### Neni 37

#### Vënia në ngarkim e humbjeve

1. Asambleja e Përgjithshme mund të vendosë që humbjet e vitit të vihen në ngarkim të një llogarie të veçantë që të shlyhen nga rezultate positive brenda një afati maksimal prej 7 vitesh.
2. Në rastin kur Asambleja e Përgjithshme vendosë të kompensojë humbjet në atë vit ekonomik që janë shkaktuar, vendimi që merret në lidhje me këtë gjë duhet të shqyrtojë kriteret për kryerjen e kompensimit, duke zbatuar në cilindo rast rregullat e mëposhtme:
  - a. Të gjitha humbjet mund ti ngarkohen fondeve që zotëron Shoqëria, pa kufizime të tjera se sasia ekzistente në këtë fond. Në fillim humbejt i ngarkohet Fondit të Rrezikut dhe më pas Fondit të Rezerves së Detyrueshme.
  - b. Sasia e pa kompensuar nga fondet e detyrueshme dhe vullnetare do të kalojë në ngarkim të anëtarëve në proporcion me asktivistet e realizuara nga sejcili prej tyre me Shoqërinë.
3. Humbjet e vëna në ngarkim të çdo anëtari duhet të shlyhen nga ky i fundit si mëposhtë:
  - a. Anëtari bën shlyerjen e humbjeve me ndonjë kontribut financiar në shoqërinë që kap vleren e shlyerjes që duhet të bëjë, brenda vitit akademik të pas atij viti që u shkaktuan humbjet.

*Angjelo*  
2022

*Alkesh*

*Mirza*

*Beard*  
*Alkesh*

*Eni*  
*Alkesh*

*Alkesh*

- b. Shlycrjet që i takojnë të bëjë anëtari mund të përmbushen në tre vite që do pasojnë nëse kështu e vëndosë Asambleja e Përgjithshme. Nëse kalon ky afat dhe humbejt nuk janë shlyer, atëherë Administratori merr masa sipas përcaktimit të këtij statute dhe rregullores.

**KAPITULLI V**  
**DOKUMENTACIONI I SHOQËRISË DHE I KONTABILITETIT**

**Neni 38**


**Dokumentacioni i Shoqërisë**

1. Shoqëria mban të dhënat e veprimtarisë së saj në:
  - a. Regjistrimin e anëtarëve;
  - b. Regjistrin e vendimeve të organeve të saj;
  - c. Regjistrat për veprime financiare dhe kontabël;
2. Mbajtja e regjistrave të shoqërisë është nën përgjegjësinë e Administratorit.

**Neni 39**

**Kontabiliteti dhe llogaritë vjetore**

1. Shoqëria mban kontabilitetin e veprimtarisë së saj ekonomike, nëpërputhje me ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 " Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare " të ndryshuar.
2. Administratori përgatit raportin e veprimtarisë, inventaret dhe llogaritë vjetore, në përputhje me legjislacionin kontabël, të cilat ia paraqet Asamblesësë Përgjithshme për miratim.
3. Emerohet për një periudhë 3 vjeçare si ekspert kontabël I autorizuar z. Gilbert Marku cili kryen edhe të gjitha proceduarit.





## Neni 40

### Auditimi i pasqyrave financiare

Pasqyrat financiare të Shoqërisë përgatiten sipas legjislacionit në fuqi dhe dispozitave për Shoqëritë me përgjegjësitë kufizuar, të përcaktuar në ligjin nr. 10091, dt 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar", tëndryshuar".

Anëtarët e Shoqërisë së Bashkëpunimit Bujqësorë "Pulti Për Zhvillim Shkodër - Albania" miratojnë këtë Statut duke nënshkruar si mëposhtë:








1. Tom Marku Tom Marku 
2. Petrit Rrushaj Petrit Rrushaj 
3. Vilson Peshkaj Vilson Peshkaj 
4. Mjalinda Kalaj Mjalinda Kalaj 
5. Nikolin Gjinaj Nikolin Gjinaj 
6. Lekë Suka Lekë Suka 
7. Marjan Kurteza Marjan Kurteza 
8. Vidë Gurra Vidë Gurra 
9. Gjini Mani Gjini Mani 

Fig 3



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË  
DEGA VENDORE SHKODËR  
NOTER FLLADINA F. KASTRATI



DATE 16/05/2022  
NR REP 1426

VËRTETIM NËNSHKRIMI

Sot, më datë 16/05/2022, para meje Notere FLLADINA F. KASTRATI, auçtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore SHKODËR, me zyrë në adresën Shkoder, Rruga "Don Bosco", Ndertesa "Pysqyli", Bashkia Shkoder,, u paraqit personalisht:

**NËNSHKRUESI:**

Tom Marku, atësia Ndok, amësia Leze, shtetas Shqiptar, lindur në Kir, Shkodër dhe banues në SHKODËR, me adresë Vas Kiri 03450013; Nd. 33; H. 1; Pult; Kir; 4010; Shkodër, lindur më 26/04/1956, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 036692139 dhe nr. personal F60426065F , .

**NËNSHKRUESI:**

Petrit Rrushaj, atësia Gjok, amësia Shaqe, shtetas Shqiptar, lindur në Plan, Shkodër dhe banues në SHKODËR, me adresë Mariaj 03400057; Nd. 18; H. 1; Bërdicë, Bërdice E Siperme; 4018; Shkodër, lindur më 01/01/1974, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 032845772 dhe nr. personal H40101067C , .

**NËNSHKRUESI:**

Vilson Peshkaj, atësia Lekë, amësia Prendë, shtetas Shqiptar, lindur në Gjuraj, Shkodër dhe banues në SHKODËR, me adresë Bokes 03450003; Nd. 18; H. 1; Pult; Gjuraj; 4010; Shkodër, lindur më 24/07/1990, gjendja civile "beqar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 034173803 dhe nr. personal J00724046T , .

**NËNSHKRUESI:**

Lekë Suka, atësia Ndre, amësia Katrinë, shtetas Shqiptar, lindur në Gjuraj, Shkoder dhe banues në MALËSI E MADHE, me adresë Boric Vogel 03660014; Nd. 48; H. 1; Gruemirë, Boriç I Vogël; 4302; Malësi E Madhe, lindur më 28/03/1969, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 037244400 dhe nr. personal G90328105D , .

**NËNSHKRUESE:**

Majlinda Kalaj, atësia Preç, amësia Diell, shtetas Shqiptar, lindur në Shkodër dhe banues në Shkodër, me adresë Banja E Vogel (Raj 4); Nd. 190; H. 00; Ap. 000; Shkodër; Shkodër; 4001; Shkodër, lindur më 21/05/1989, gjendja civile "beqare", madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Leternjoftim ID nr. 034173828 dhe nr. personal I95521055P , .

**NËNSHKRUESI:**

Nike Gjinaj, atësia Gjon, amësia File, shtetas Shqiptar, lindur në Megulle, Shkodër dhe banues në SHKODËR, me adresë Beshlidhja 03460019; Nd. 28; H. 1; Rrethinat; Hot I Ri; 4015; Shkodër, lindur më 06/01/1975, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 034983115 dhe nr. personal H50106096S , .





722264035006735965

**NËNSHKRUESI:**

Marjan Kurteza, atësia Nike, amësia Dile, shtetas Shqiptar, lindur në Xhan, Shkodër dhe banues në SHKODËR, me adresë Rr. Rina 03460206, Nd. 11; H. 1; Rrethinat; Shtoj I Ri; 4015; Shkodër, lindur më 07/04/1986, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 036849166 dhe nr. personal I60407109B .

**NËNSHKRUESE:**

Vidë Gurra, atësia Ndoc, amësia Prendë, shtetas Shqiptar, lindur në Prekal, Shkodër dhe banues në Shkodër, me adresë Ndoc Mazi; Nd. 064; H. 00; Ap. 000; Shkodër, Shkodër; 4001; Shkodër, lindur më 08/05/1971, gjendja civile "e martuar", madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 034209053 dhe nr. personal H15508162W .

**NËNSHKRUESIT:**

Gjin Mani, atësia Kol, amësia Drande, shtetas Shqiptar, lindur në Kir, Shkodër dhe banues në SHKODËR, me adresë Mark Nonaj 03450017, Nd. 18; H. 1; Pult; Kir; 4010; Shkodër, lindur më 07/08/1967, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 037179890 dhe nr. personal G70807021C .

Subjektet e mësipërme, në vullnet të lirë dhe të plotë, u paraqitën dhe nënshkruan përpara meje Noteres, "STATUTIN E SHOQERISE SE BASHKËPUNIMIT BUJQESOR (SH.R.B.) "PUTI PER ZHVILLIM - SHKODER ALBANIA", bashkëlidhur.

Unë Noterja, pasi verifikova identitetin e personave të sipërcituar, nëpërmjet mjeteve të identifikimit në përputhje të plotë me nenin 62, pika 1, gërma "ë", si dhe nenin 128 të ligjit nr. 110/2018 "Për Noterinë", dhe Udhëzimit të Ministrisë së Drejtësisë nr. 6291, datë 17.08.2005, vërtetoj nënshkrimin e tyre.

Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjektit të këtij veprimi në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

**NOTER**

FIJLADINA F. KASTRATI

